

Bordi Ekzekutiv i FMN-së miraton një marrëveshje 330.9 milion euro për Shqipërinë

Njoftim për shtyp Nr.14/81

28 Shkurt, 2014

Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) miratoi sot marrëveshjen 36-mujore prej 295.42 milionë SDR (rreth 330.9 milion euro, ose 457.1 milion dollarë; 492.4 përqind e kuotës së vendit në Fond) *Instrumenti i Zgjeruar i Fondit (Extended Fund Facility – EFF)* me Shqipërinë për të mbështetur programin e reformave të autoriteteve. Miratimi mundëson disbursimin e menjëhershëm të 23.55 milionë SDR (rreth 26.4 milionë euro, ose rreth 36.4 milionë dollarë). Banka Botërore dhe Bashkimi Europian ka gjithashtu mundësi që të ofrojnë asistencë për programin e reformave të autoriteteve.

Në vijim të diskutimeve të Bordit Ekzekutiv për Shqipërinë, z. David Lipton, zëvendës-drejtor i parë dhe kryetari në detyrë, tha:

“Ecuria ekonomike e Shqipërisë pritet të përmirësohet në 2014 e mbështetur nga ulja e planifikuar e rreziqeve themelore në fushën fiskale, shlyerja e detyrimeve të prapambetura, adresimi i nivelit të lartë të kredive nën standart dhe nisja e reformave strukturore. Megjithatë, rreziqet janë të konsiderueshme dhe nevojat për refinancim të mëdha. Programi EFF do të ndihmojë Shqipërinë për të plotësuar nevojat e saj për financim të jashtëm, duke ofruar njëkohësisht mbështetjen e nevojshme për të forcuar qëndrueshmërinë fiskale dhe të borxhit, të ulë rrezikun e financave publike dhe të vendosë ekonominë në një rrugë rritjeje të qëndrueshme afatmesme.

“Niveli i lartë i borxhit kërkon një konsolidim fiskal që synon të ulë borxhin publik poshtë 60 përqindëshit të PBB-së në afatin e mesëm. Kjo do të kërkojë masa domethënëse në politikën tatimore dhe të shpenzimeve. Ulja e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe vendosja e një mekanizmi që parandalon rikrijimin e tyre do të jetë gjithashtu kritike.

“Një lehtësim i mëtejshëm i moderuar i politikës monetare mund të ndihmojë në mbështetjen e rigjallërimit ekonomik, në rast se pritshmëritë për inflacionin dhe stabilitetin financiar mbeten të mirëankoruara. Megjithatë kjo do të duhet të peshohet me kujdes kundrejt rreziqeve që sjell ekspozimi i lartë në valutë.

“Ruajtja e stabilitetit financiar duke përmirësuar aksesin në kreditim është e nevojshme për të ndihmuar një rigjallërim të qëndrueshëm. Ulja e kredive nën standart do të ruajë stabilitetin financiar dhe mund të ndihmojë që të ulë pengesat në ofertën e kreditimit duke reduktuar ngurrimin e bankave. Zbatimi i shpejtë i rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP), përfshirë dhe ato që lidhen me uljen e rreziqeve në sektorin jo-bankar, do të jenë të rëndësishme.

“Planet e autoriteteve për të reformuar pensionet, energjinë, financat e pushtetit vendor, administratën publike, si dhe mjedisin e biznesit, janë të mirëpritura. Nëse zbatohen si duhet, këto reforma duhet të përmirësojnë aftësinë e Shqipërisë për të tërhequr investime, të përmirësojnë prespektivën për rritje të qëndrueshme afatmesme dhe të ulin rreziqet fiskale”, tha z. Lipton.